

## RAPORT I PËRKOHSHËM 25 shkurt – 11 mars 2013

13 mars 2013

### I. PËRMBLEDHJE E SHKURTËR

- Zgjedhjet për kryetarët e komunave dhe këshillat komunalë të 80 komunave dhe të Qytetit të Shkupit do të mbahen më 24 mars. Kryetarët e komunave zgjidhen në bazë të modelit të shumicës, ndërsa këshillat komunalë zgjidhen sipas modelit proporcional. Nëse njëri nga kandidatët për kryetar komune nuk e fiton shumicën absolute të votave në rrethin e parë dhe nëse përqindja e atyre që kanë dalë në votime është më pak se një e treta e votuesve të regjistruar në komunë, atëherë brenda dy javësh organizohet rrethi i dytë i zgjedhjeve ndërmjet dy kandidatëve që kanë fituar më së shumti vota.
- Më 2 janar, Lidhja Social Demokratike e Maqedonisë (LSDM) njoftoi se do t'i bojkotojë zgjedhjet lokale, në qoftë se nuk i plotësohen disa kërkesa. Për pothuajse dy muaj, partia në pushtet, Organizata e Brendshme Revolucionare e Maqedonisë – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) dhe LSDM-ja nuk ia arritën të gjejnë kompromis për t'i dhënë fund krizës politike. Më 1 mars, liderët partiakë më në fund arritën marrëveshje të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, që i dha fund bojkotit opozitar në parlament dhe të zgjedhjeve lokale. Afati për dorëzimin e kandidaturave u vazhdua deri më 8 mars.
- Kandidatët mund të nominohen nga partitë e regjistruara politike, koalicionet, si dhe grupet e votuesve. Kërkesa e 8 marsit e VMRO-DPMNE-së për tërheqjen e listës së këshilltarëve në Kërçovë dhe në Strugë, u refuzua nga këshillat zgjedhore komunale (KZK) përkatëse. Dy KZK-të e refuzuan edhe listën e kandidatëve të LSDM-së, me arsyetimin se në lista kishte emra të kandidatëve që tashmë gjendeshin në listën e verifikuar më parë të VMRO-DPMNE-së. Gjykata Administrative i hodhi poshtë të dy vendimet. Deri në afatin e vazhduar të 8 marsit, u dorëzuan gjithsej 341 lista për kryetarë komunash dhe 439 lista për këshilltarë nga 16 parti politike, 6 koalicione dhe 89 grupe qytetarësh.
- Zgjedhjet lokale do të administrohen nga administrata e organizuar në tre nivele, që përbëhet nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ), 80 KZK dhe Komisioni Zgjedhor për Qytetin e Shkupit, dhe 2,976 këshilla zgjedhorë. Mbledhjet e KSHZ-së që u ndoqën nga Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) i OSBE/ODIHR-it, gjatë kësaj periudhe të raportimit, u mbajtën në mënyrë profesionale dhe kolegjiale. Megjithatë, në mbledhjen e mbajtur më 8 mars, është vërejtur tension gjatë diskutimeve të gjata dhe kundërshtuese në lidhje me kërkesën e VMRO-DPMNE-së.
- Numri përfundimtar i votuesve të regjistruar është 1,743,403, ndërsa rreth 43,633 votues i kanë kontrolluar të dhënat e regjistrimit në zyrat rajonale të KSHZ-së gjatë periudhës së shikimit publik. Ministria për Punë të Brendshme e ka informuar MVZ i OSBE/ODIHR-it që rreth 119,000 qytetarë nuk janë përfshirë në listat e votuesve, për arsye se nuk i posedojnë

letërnjoftimet ose pasaportat e nevojshme biometrike.

- Fushata zgjedhore zyrtarisht filloi më 4 mars, edhe pse MVZ i OSBE/ODIHR-it ka vërejtur aktiviteve të fushatës para kësaj date. Në përgjithësi fushata ka qenë e qetë deri tani, por disa incidente të izoluara që ndërlidhen me zgjedhjet dhe disa protesta të dhunshme lidhur me emërimin e ministrit të ri të Mbrotjtjes, kanë ndikuar negativisht në ambientin e fushatës.
- OSBE/ODIHR-i i filloi aktivitetet e tij në Shkup më 25 shkurt, me një ekip kryesor 11-anëtarësh. Më 2 mars, 16 vëzhgues afatgjatë u shpërndanë në tërë vendin. MVZ i OSBE/ODIHR-it e ka mbikëqyrur mbulimin e zgjedhjeve nga ana e medimeve që nga 25 shkurti.

## II. HYRJE

Zgjedhjet lokale u shpallën më 11 janar 2013 për datën 24 mars, në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe ligjore. Pas ftesës nga Ministria për Punë të Jashtme, në bazë të rekomandimit të Misionit për Vlerësimin e Nevojave që u realizua në periudhën prej 28 deri më 31 janar,<sup>1</sup> Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e OSBE-së (OSBE/ODIHR) më 25 shkurt e krijoi Misionin për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ). MVZ i OSBE/ODIHR-it, udhëhiqet nga Ambasadori Geert-Hinrich Ahrens dhe përbëhet nga ekipi kryesor 11-anëtarësh i vendosur në Shkup, si dhe 16 vëzhgues afatgjatë (VA) të shpërndarë në tërë vendin. Anëtarët e MVZ-së vijnë nga 17 vende anëtare të OSBE-së. OSBE/ODIHR ka kërkuar nga vendet anëtare të OSBE-së të dërgojnë 300 vëzhgues afatshkurtë për ta mbikëqyrur votimin, numërimin dhe shënimin e rezultateve në ditën e zgjedhjeve.

## III. KONTEKSTI POLITIK

Pas përjashtimit të dhunshme të deputetëve opozitarë dhe të përfaqësuesve të mediave nga parlamenti, gjatë votimit të buxhetit vjetor më 24 dhjetor 2012, Lidhja Social Demokratike e Maqedonisë (LSDM), që është partia kryesore opozitare, së bashku me disa partnerë të koalicionit e filluan bojkotimin e parlamentit.

Më 2 janar, LSDM-ja njoftoi se do t'i bojkotojë edhe zgjedhjet lokale, përderisa nuk plotësohen disa kërkesa, përfshirë edhe mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, ndryshimin e Kodit Zgjedhor ku do të përfshihen rekomandimet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it, shqyrtimin e listës së votuesve, si dhe dorëheqjen e Ministrit të Financave, Ministres për Punë të Brendshme dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Transmetuesit Publik - Radio dhe Televizionit të Maqedonisë (RTM).

Për pothuajse dy muaj, partia në pushtet, Organizata e Brendshme Revolucionare e Maqedonisë – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) dhe LSDM-ja nuk ia arritën të gjejnë kompromis për t'i dhënë fund krizës politike. Më 1 mars, liderët partiakë më në fund arritën marrëveshje të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, që i dha fund bojkotit opozitar në parlament dhe të zgjedhjeve lokale.<sup>2</sup> Të nesërmen, në seancë të jashtëzakonshme, parlamenti e vazhdoi afatin për regjistrimin e kandidatëve deri më 8 mars, duke e mundur regjistrimin e kandidatëve të koalicionit opozitar “Aleanca për adhmërinë”.

---

<sup>1</sup> Raporti i Misionit për Vlerësimin e Nevojave dhe raportet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it gjenden në: <http://www.osce.org/odihr/elections/fyrom>.

<sup>2</sup> Teksti i marrëveshjes mund të gjendet në: [http://ec.europa.eu/commission\\_2010-2014/fule/headlines/news/2013/03/20130301\\_en.htm](http://ec.europa.eu/commission_2010-2014/fule/headlines/news/2013/03/20130301_en.htm).

#### IV. KORNIZA LIGJORE DHE SISTEMI ZGJEDHOR

Korniza ligjore për zgjedhjet lokale përcaktohet kryesisht me Kushtetutën dhe me Kodin Zgjedhor gjithpërfshirës të miratuar në vitin 2006 dhe të ndryshuar për herë të fundit më 2 mars 2013.<sup>3</sup> Ndryshimet e fundit e vazhduan afatin për dorëzimin e listave të kandidatëve deri më 8 mars dhe vlejné vetëm për këto zgjedhje.<sup>4</sup> Afatet e tjera në Kodin Zgjedhor nuk u ndryshuan për ta pasqyruar këtë vazhdim, duke shkaktuar huti tek palët e përfshira në zgjedhje, për atë se kur fillon zyrtarisht fushata zgjedhore.

Në Mendimin e Përbashkët të vitit 2011 për Kodin Zgjedhor, OSBE/ODIHR dhe Komisioni Evropian për Demokraci nëpërmjet ligjit (Komisioni i Venedikut) përfundoi që ndonëse disa rekomandime të mëparshme janë përmbushur, “mbeten disa çështje që duhet të trajtohen edhe më tej”.<sup>5</sup> Në marrëveshjen me të cilën u zgjodh kriza politike, pushteti dhe opozita vendosën të vazhdojnë me reformën zgjedhore pas zgjedhjeve lokale, në bazë të rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it.

Zgjedhjet për kryetar komune dhe këshilla komunalë mbahen çdo katër vjet, në gjysmën e dytë të muajit mars. Secila prej 80 komunave dhe Qyteti i Shkupit zgjedhin kryetar komune dhe këshill komunal. Kryetarët e komunave zgjidhen sipas modelit të shumicës, që përbëhet nga dy rrethe. Për t’u zgjedhur kryetar komune në rrethin e parë, kandidati duhet të fitojë mbi 50 përqind të votave, por me kusht që në votime të kenë marrë pjesë së paku një e treta e votuesve që gjenden në listën e votuesve. Në të kundërtën, brenda dy javësh mbahet rrethi i dytë ndërmjet dy kandidatëve që e kanë fituar numrin më të madh të votave. Nuk ka kërkesë të veçantë për numrin e votuesve që dalin në votime në rrethin e dytë.

Këshilltarët komunalë zgjidhen sipas modelit të përfaqësimit proporcional me lista të mbyllura dhe ulëset ndahen sipas formulës së *d’Hondt*-it. Nuk ka kërkesë të veçantë për numrin e votuesve që dalin në votime për zgjedhjet për këshillat komunalë. Numri i këshilltarëve që zgjidhen për çdo komunë varet nga numri i banorëve. Numri i këshilltarëve nuk mund të jetë më i ulët se 9 e as më i lartë se 33, përveç në Qytetin e Shkupit, ku numri i këshilltarëve është 45.

#### V. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Zgjedhjet lokale administrohen nga administrata e organizuar në tre nivele, që përbëhet nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ), 80 komisione zgjedhore komunale (KZK) dhe Komisioni Zgjedhor për Qytetin e Shkupit, dhe 2,976 këshilla zgjedhore (KZ).

KSHZ është organ i përhershëm që është përgjegjës për realizimin e gjithmbarshëm të zgjedhjeve. Përbëhet nga shtatë anëtarë të emëruar nga parlamenti me shumicë prej dy të tretave, me mandat katërvjeçar. Kryetari i KSHZ-së dhe dy anëtarë të tij emërohen nga partitë opozitare, ndërsa nënkryetari dhe tre anëtarë emërohen nga partitë në pushtet. Mbledhjet e KSHZ-së janë të hapura për vëzhguesit e akredituar dhe mediat. Mbledhjet që u ndoqën nga MVZ i OSBE/ODIHR-it gjatë kësaj periudhe të raportimit, u mbajtën në mënyrë profesionale dhe

---

<sup>3</sup> Ligjet e tjera që kanë të bëjnë me zgjedhjet janë Ligji për Veprimtari Radiodifuzive, Ligji për Partitë Politike, Ligji për Financimin e Partive Politike, Ligji për Nëpunësit Shtetërorë, Ligji për Kontestet Administrative, Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Ligji për Administrim Territorial të Vetëqeverisjes Lokale dhe Kodi Penal.

<sup>4</sup> Amandamenti u miratua me 84 vota për dhe një kundër. Kjo ishte hera e parë pas 24 dhjetorit 2012, që LSDM-ja dhe partitë e tjera opozitare të kthehen në Kuvend.

<sup>5</sup> Mendimi i Përbashkët për Kodin Zgjedhor të Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Mendimi Nr. 640/2011, CDL-AD(20011)027: <http://www.osce.org/odihr/84226>.

kolegiale dhe procesverbalet e secilës mbledhje u publikuan në ueb-faqen e KSHZ-së. Megjithatë, në mbledhjen e mbajtur më 8 mars, është vërejtur tension gjatë diskutimeve të gjata dhe kundërshtuese në lidhje me kërkesën e VMRO-DPMNE-së për tërheqjen e listave në Strugë dhe Kërçovë.

KZK-të janë përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve në komunën e tyre. Ato i emërojnë dhe mbikëqyrin punën e KZ-ve, që nga ana tjetër, janë përgjegjëse për zbatimin e procedurave të ditës së zgjedhjeve nëpër vendvotime. Çdo KZK dhe KZ ka kryetar, katër anëtarë dhe pesë zëvendës. Anëtarët e KZK-së zgjidhen në mënyrë të rastësishme, nga radhët e të punësuarve në administratën lokale. KZ-të janë të përbëra nga një model i përzier profesional-politik, me një anëtar të emëruar nga partitë politike në pushtet, një nga partitë opozitare, dhe tre anëtarë të zgjedhur në mënyrë të rastësishme nga të punësuarit në administratën publike. Trajnimi i KZK-ve është realizuar nga KSHZ-ja më 28 shkurt. KZK-të planifikojnë t'i trajnojnë KZ-të në periudhën mes 1 dhe 21 marsit.

Kodi Zgjedhor parashesh përfaqësim të drejtë etnik dhe gjinor në administratën zgjedhore.<sup>6</sup>

## VI. REGJISTRIMI I VOTUESVE

Regjistrimi i votuesve është pasiv dhe KSHZ-ja është përgjegjëse për mirëmbajtjen e listave të votuesve, në bazë të informatave të marra nga regjistrat që mbahen nga Ministria për Punë të Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë. Mund të regjistrohen të gjithë qytetarët që kanë mbushur 18 vjet ose kanë më tepër në ditën e zgjedhjeve, që kanë vendqëndrim në komunën e tyre, që kanë letërnjoftim ose pasaportë valide biometrike, dhe të cilëve nuk u është mohuar aftësia e tyre ligjore me ndonjë vendim gjyqësor. MVZ i OSBE/ODIHR-it është informuar nga Ministria e Punëve të Brendshme se rreth 119,000 qytetarë nuk janë përfshirë në listat e votuesve për shkak se nuk posedojnë letërnjoftime ose pasaporta biometrike.

Sipas KSHZ-së, janë regjistruar 1,743,403 qytetarë me të drejtë vote në këto zgjedhje. Gjatë periudhës së shqyrtimit publik, rreth 43,633 njerëz i kanë kontrolluar të dhënat e tyre në listat zgjedhore, në zyrat rajonale të KSHZ-së.<sup>7</sup> Janë pranuar gjithsej 1,788 kërkesa për regjistrime të reja, 4 prej të cilave janë refuzuar. Janë pranuar rreth 1,173 kërkesa për ndryshime të të dhënave. Përveç kësaj, janë miratuar edhe 3 kërkesa për shlyerjen e personave nga lista zgjedhore. Votuesit kishin mundësi edhe për kontrollimin e detrajeve të tyre nëpërmjet një programi në internet.

Ministria për Drejtësi ia ka dorëzuar KSHZ-së të dhënat për personat që janë në paraburgim ose që janë duke vuajtur dënim me burg. Ka 11 qendra paraburgimi dhe burgje, me 1,446 të burgosur që janë regjistruar në ekstraktet e listave speciale zgjedhore. Votimet nëpër burgje, si dhe për votuesit që nuk mund të dalin nga shtëpia dhe për ata që janë në arrest shtëpiak, do të mbahen një ditë para ditës së zgjedhjeve.

## VII. PARAQITJA E KANDIDATËVE

Kandidati duhet të ketë të drejtë vote dhe të jetë banor i komunës ku ai/ajo do të garojë në zgjedhje. Në zgjedhjet lokale mund të garojnë kandidatë të nominuar nga partitë e regjistruara politike ose koalicionet e partive politike, ose kandidatë të pavarur të emëruar nga grupet e votuesve.

---

<sup>6</sup> Bashkësitë etnike që përbëjnë më shumë se 20 përqind të popullatës së një komune janë të përfaqësuara në KZK-të dhe KZ-të, ndërsa së paku 30 përqind e anëtarëve në të gjitha komisionet zgjedhore duhet të jenë nga secila gjini.

<sup>7</sup> Periudha e shikimit publik ishte prej 26 janarit deri më 9 shkurt 2013.

Kandidatura e kandidatëve të pavarur duhet të përkrahet me 100 deri në 450 nënshkrime, varësisht nga madhësia e komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit kërkohet përkrahje me 1.000 nënshkrime. Ligji identifikon edhe një sërë pozitash qeveritare dhe pozitash që kanë lidhje e qeverinë, si të papajtueshme me pozitën e anëtarit të këshillit komunal ose të kryetarit të komunës.

Listat e kandidatëve për zgjedhjet lokale dorëzohen në KZK-në përkatëse. Çdo i treti vend në listë duhet të jetë i rezervuar për gjininë e përfaqësuar më pak. Në komunat ku mbi 20 përqind e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, listat e kandidatëve mund të dorëzohen edhe në gjuhën përkatëse.

Përkundër raporteve zakonisht konfrontuese, VMRO-DPMNE-ja dhe LSDM-ja janë pajtuar që t'i përkrahin kandidatët e njëra-tjetrës në vendet ku ka garë të ngushtë mes kandidatit maqedonas dhe atij shqiptar për kryetar komune, siç është rasti në Kërçovë dhe Strugë. Më 8 mars, VMRO-DPMNE-ja dorëzoi një kërkesë deri te KSHZ-ja, për t'ia mundësuar tërheqjen e listës së saj me kandidatë për këshilltarë komunalë në Kërçovë dhe Strugë. Pas një debati me kundërshtime, KSHZ-ja votoi pesë kundër një përgjatë vijave etnike, për ta lejuar tërheqjen.<sup>8</sup> Megjithatë, KZK-të në të dy komunat nuk e pranuan vendimin e KSHZ-së dhe votuan kundër lejimit të VMRO-DPMNE-së për tërheqjen e listave. Në vijim, ata e refuzuan listën e dorëzuar nga LSDM-ja, meqë përmbante emra të kandidatëve që tashmë ishin në listën e verifikuar të VMRO-DPMNE-së.<sup>9</sup>

LSDM-ja u ankua në Gjykatën Administrative për refuzimin e listave nga KZK-ja. Më 9 mars Gjykata i anuloi vendimet e të dy KZK-ve. Si rezultat i kësaj, listat e VMRO-DPMNE-së u tërhoqën dhe listat e përbashkëta të LSDM-së dhe të VMRO-DPMNE-së janë pranuar në të dyja komunat.

Deri në përfundim të afatit të vazhduar më 8 mars, janë dorëzuar gjithsej 381 lista për kryetarë komunash dhe 439 lista për këshilla komunalë nga 16 parti politike, 6 koalicionë dhe 89 grupe qytetarësh.

## VIII. FUSHATA DHE FINANCIMI I FUSHATËS

Si rezultat i krizës së fundit politike, këto zgjedhje kanë fituar rëndësi më të madhe politike, me tendencë për fokusim më të madh tek çështjet nacionale dhe jo ato lokale. Lideri i koalicionit të VMRO-DPMNE-së që është në pushtet, iu referua zgjedhjeve lokale si referendum për ardhmërinë e vendit, ndërsa kryetari i LSDM-së insistoi se rezultatet e zgjedhjeve duhet të vendosin nëse do të mbahen zgjedhje të parakohshme parlamentare apo jo.<sup>10</sup>

Fushata zgjedhore filloi zyrtarisht më 4 mars dhe do të përfundojë më 22 mars në mesnatë. Ndonëse i ndalon aktivitetet e fushatës para datës zyrtare të fillimit të fushatës, MVZ i OSBE/ODIHR-it ka vërejtur disa ngjarje që janë mbajtur që më 2 mars, përfshirë ngjarjet në Kërçovë (Bashkimi Demokratik për integrim, BDI) dhe në Shtip (VMRO-DPMNE), ku janë prezantuar programet zgjedhore të kandidatëve. Poashtu, për shkak të bojkotit dhe vazhdimit të afatit për regjistrim, partitë që janë pjesë e koalicionit opozitar "Aleanca për ardhmërinë", e filluan fushatën para verifikimit të kandidatëve dhe listave të tyre nga administrata zgjedhore.

---

<sup>8</sup> Nënkryetari nuk mori pjesë në votim sepse e lëshoi mbledhjen para se të bëhej votimi.

<sup>9</sup> Neni 57(2) i Kodit Zgjedhor nuk e lejon që një kandidat të paraqitet në dy lista të ndryshme. MVZ i OSBE/ODIHR-it u informua se listat e LSDM-së në Strugë dhe në Kërçovë kishin 12, respektivisht 13 kandidatë, të cilët ishin në listën paraprake të VMRO-DPMNE-së.

<sup>10</sup> Fjalimi i Nikolla Gruevskit (VMRO-DPMNE) në hapjen e fushatës "Për Maqedoni më të mirë" në Ohër më 4 mars. Branko Crvenkovski (LSDM) e bëri këtë deklaratë më 4 mars në tubimin e parë në Strumicë.

Tensionet nga kriza dy-mujore e kanë acaruar tonin e fushatës zgjedhore. Megjithatë, fushata deri tani ka qenë me dukshmëri të matur anembanë vendit, me tubime dhe takime që janë mbajtur në disa qytete me numër më të madh banorësh.<sup>11</sup> Billbordet dhe posterët mund të shihen anembanë vendit dhe pothuajse të gjitha partitë politike dhe disa kandidatë të pavarur i kanë shfrytëzuar mediumet sociale dhe ueb-faqet e tyre për të kontaktuar me elektoratin. Disa parti politike kanë shprehur shqetësim për keqpërdorimin e mundshëm të burimeve administrative dhe frikësimin e votuesve, veçanërisht të të punësuarve në administratën publike. Shumica e kandidatëve fushatën e tyre e zhvillojnë kryesisht brenda një komuniteti etnik, ndërsa shumë pak garues kanë bërë fushatë në elektorat multietnik.

Edhe pse ngjarjet e fushatës deri tani kanë qenë të qeta, mediumet kanë raportuar për disa incidente të izoluara që ndërlidhen me zgjedhjet. Për më tepër, rastet e protestave të dhunshme të lidhura me emërimin e Talat Xhaferit nga partia e koalicionit qeveritar BDI, për ministër të ri të Mbrojtjes, kanë ndikuar negativisht në ambientin e fushatës. Disa parti politike i kanë lidhur protestat dhe incidentet e dhunshme në vend me fushatën zgjedhore që është në vijim e sipër, duke i akuzuar kundërshtarët e tyre se përpiqen të përfitojnë nga ngritja e tensioneve etnike para zgjedhjeve të 24 marsit.

Të gjithë garuesit në zgjedhje janë të obliguar të hapin xhiro-llogari të veçantë bankare për donacionet dhe shpenzimet e fushatës, si mënyrë e vetme e financimit të fushatës. Në fillim të marsit, Ministria e Financave organizoi në Shkup një trajnim për partitë politike për formularët e ri për financimin e fushatës. Kandidatët dhe partitë duhet ta dorëzojnë raportin e parë të përkohshëm për shpenzimet e fushatës më 14 mars, ndërsa të dytin më 23 mars. Afati i fundit për raportin përfundimtar është 30 ditë pasi të përfundojë fushata. Raportet duhet t'i dorëzohen KSHZ-së, Entit Shtetëror për Revizion dhe Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. Në afat prej 60 ditëve nga dorëzimi i raportit përfundimtar, Enti Shtetëror për Revizion duhet ta shqyrtojë atë dhe të ngrisë procedurë kundërvajtëse nëse konstaton se ka parregullsi që janë në kundërshtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor.

Shpenzimet e fushatës kufizohen në 180 denarë (3 euro) për çdo votues të regjistruar në komunën për të cilën është dorëzuar lista. Financimi i fushatës mund të bëhet vetëm nëpërmjet anëtarësisë, donacioneve nga personat fizikë deri në 5.000 euro, si dhe nga personat juridikë deri në 5 përqind të të ardhurave të përgjithshme gjatë vitit të kaluar.<sup>12</sup>

## IX. MEDIAT

Numri i madh i mediave të regjistruara në vend janë të ndara në bazë gjuhësore dhe politike. Televizioni mbetet mediumi kyç dhe burimi kryesor i informimit politik në vend. Roli i internetit dhe i rrjeteve sociale është rritur gjatë viteve të fundit.

Kodi Zgjedhor, Ligji për Veprimtari Radiodifuzive dhe rregulloret e miratuara nga Këshilli për Radiofiuzion (KR) e formojnë kornizën kryesore ligjore për rregullimin e fushatës zgjedhore në media. KR-ja e mbikëqyr respektimin e tyre nga mediat elektronike. Që nga 12 januari, KR-ja ka mbikëqyrë 27 media elektronike në nivel nacional dhe rajonal. Që nga fillimi zyrtar i fushatës, KR-ja e ka futur shumicën e media elektronike rajonale dhe lokale në mostrën e saj të mbikëqyrjes, duke e ngritur kështu numrin në 142 media elektronike.<sup>13</sup> Para fillimit zyrtar të

---

<sup>11</sup> MVZ i OSBE/ODIHR-it ka mbikëqyrur 18 tubime anembanë vendit gjatë periudhës së raportimit.

<sup>12</sup> Kodi Zgjedhor parasheh limit prej 5.000 eurosh, që është përafërsisht 30.500 denarë.

<sup>13</sup> KR-ja ka vendosur që të mos i mbikëqyrë nëntë radio stacione, për shkak se këto media vendosën të mos e mbulojnë fushatën zgjedhore dhe të mos emitojnë asnjë reklamë politike.

fushatës, KR-ja ka pranuar dy ankesa. Në javën e parë të fushatës janë dorëzuar tre ankesa.

Transmetuesi publik, Radio Televizioni i Maqedonisë (RTM), është i obliguar të ndajë kohë të lirë për emitim pa pagesë. Ligji nuk e parashesh kohëzgjatjen e kohës së ndarë ose kur duhet të bëhet emitimi. RTM-ja vendosi t'u ndajë nga dy minuta çdo kandidati për kryetar komune dhe një minutë për secilin kandidat në listën për këshill komunal. Koha duhet të shfrytëzohet vetëm nga garuesit për të cilët është ndarë. RTM-ja planifikon të organizojë 5 debate në gjuhën maqedonase dhe 18 debate në gjuhën shqipe për kandidatët për kryetarë komunash. Poashtu, RTM-ja ka në plan të organizojë 5 programe për gjendjen aktuale, ku do të paraqiten kandidatët e komunave kryesore.

Mbikëqyrja e mediave nga MVZ i OSBE/ODIHR-it do të bëhet në dy periudha: e para prej 25 shkurtit deri më 3 mars, që do ta mbulojë periudhën para fillimit zyrtar të fushatës zgjedhore. E dyta e mbulon periudhën zyrtare të fushatës duke filluar nga 4 marsi deri më 22 mars. Mbikëqyrja e mediave përbëhet nga analiza sasiore dhe cilësore e emitimeve në kohën më të shikuar të dy TV kanaleve publike dhe pesë private, si dhe të pesë gazetave të përditshme.<sup>14</sup>

## X. ANKESAT DHE PARASHTRESAT

Për zgjedhjet lokale, KSHZ-ja është kompetente për ankesat që kanë të bëjnë me paraqitjen e kandidatëve dhe regjistrimin e votuesve, si dhe për shkeljet e tjera të të drejtës së votës. Ankesat ndaj këtyre vendimeve shqyrtohen nga Gjykata Administrative, vendimet e së cilës janë përfundimtare. Ankesat për keqpërdorimet zgjedhore që konsiderohen si kundërvajtje shqyrtohen nga gjykatat themelore, me mundësi ankesë në Gjykatën e Apelit. Janë paraparë afate të shkurtra për shqyrtimin e ankesave dhe parashtresave të lidhura me mbrojtjen e të drejtave të kandidatëve dhe të votuesve.<sup>15</sup>

Gjatë periudhës fillestare të paraqitjes së kandidatëve janë parashtruar tetë parashtresa në Gjykatën Administrative, ku kontestohet refuzimi i listave të kandidatëve: dy u pranuan dhe gjashtë u refuzuan. Me vazhdimin e afatit për paraqitjen e kandidatëve, tre lista kandidatësh të cilat fillimisht u refuzuan nga KZK-ja për shkak të dorëzimit me vonesë, u ridorëzuan dhe u pranuan.<sup>16</sup> Në Gjykatën Administrative nuk ka pasur asnjë parashtresë të lidhur me listat zgjedhore. MVZ i OSBE/ODIHR-it nuk është informuar për ndonjë parashtresë në gjykatat themelore.

Përveç dy parashtresave kundër KZK-së në Strugë dhe Kërçovë, më 9 mars, LSDM-ja ka parashtruar edhe një parashtresë në Gjykatën Administrative kundër refuzimit të listës së tyre nga KZK-ja në Shuto Orizarë. Gjykata e refuzoi ankesën e LSDM-së në bazë të kompetencës dhe dorëzimit me vonesë.

<sup>14</sup> Kanalet televizive: *TVM-1* (publik), *TVM-2* (publik), *Kanal 5*, *Sitel*, *Alsat-M*, *Telma* dhe *Alfa*. Gazetat: *Dnevnik*, *Nova Makedonija*, *Fokus*, *Koha*, *Zhurnal Plus*.

<sup>15</sup> Në disa raste ankuesi duhet ta dorëzojë ankesën në afat prej 24 orësh nga pranimi i vendimit të KZK-së dhe Gjykata Administrative duhet të vendosë brenda 24 orëve. Për ankesat që kanë të bëjnë me mbrotjen e të drejtës për të votuar, KSHZ-ja duhet të vendosë brenda katër orëve nga momenti i pranimi të ankesës. Gjykata Administrative duhet të vendosë në afat prej 24 orësh nga momenti i pranimi të vendimit të KSHZ-së.

<sup>16</sup> Lidhja e Forcave të Majta të Titos, në komunat e Aerodromit dhe të Karposhit dhe Bashkimi Social Demokratik në Gjorçe Petrov.

## **XI. VËZHGESIT NDËRKOMBËTARË DHE TË QYTETARËVE**

Kodi Zgjedhor parasheh vëzhgim ndërkombëtar të zgjedhjeve dhe mbikëqyrje nga qytetarët. Grupet mbikëqyrëse të qytetarëve duhet të jenë të regjistruara së paku një vit para ditës së zgjedhjeve dhe në statutet e tyre duhet ta përfshijnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Organizatat MOST, Civil, dhe Instituti për Demokraci planifikojnë t'i mbikëqyrin këto zgjedhje. Poashtu, çdo paraqitës i listës me kandidatë ka të drejtë të emërojë një përfaqësues të autorizuar dhe një zëvendës për ta mbikëqyrur punën e administratës zgjedhore.

## **XII. AKTIVITETET E MVZ TË OSBE/ODIHR-IT**

MVZ i OSBE/ODIHR-it e filloi punën më 25 shkurt. Shefi i MVZ-së i OSBE/ODIHR-it është takuar me Kryeministrin, ministren e Punëve të Brendshme, ministrin e Punëve të Jashtme, kryetarin e KSHZ-së, dhe me liderët e partive kryesore politike. MVZ i OSBE/ODIHR-it poashtu ka vendosur ose inicuar kontakte me institucionet qeveritare që përfshihen në procesin zgjedhor, me shoqërinë civile dhe me mediat në kryeqytet dhe në nivel rajonal. Takimi i parë me përfaqësuesit e shteteve-pjesëmarrëse të OSBE-së u mbajt më 7 mars. Gjashtëmbëdhjetë vëzhgues afatgjatë, të ndarë në çifte, takohen me palët rajonale të përfshira në procesin zgjedhor dhe i vëzhgojnë ngjarjet e fushatës zgjedhore

*Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar.  
Janë siguruar edhe përkthime jozyrtare në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.*